

VENDIM
Nr. 469, datë 26.7.2023

**PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PËRGJITHSHME TË KREDIVE TË REJA
PËR KATEGORITË PRIORITARE TË TË PUNËSUARVE PËRFITUES NË
ADMINISTRATËN PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 64/3 e 64/5, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e përgjithshme të kredive të lehtësuara për administratën publike për vitin 2023 janë 300, të cilat ndahen, si më poshtë vijon:

- a) 100 për mjekët e sistemit shëndetësor publik;
- b) 100 për punonjësit e Policisë së Shtetit;
- c) 100 për ushtarakët e Forcave të Armatosura.

2. Për kategoritë e përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij vendimi, përfituesit janë familjet e reja, të krijuara si rezultat i martesës së lidhur përpara nëpunësit të gjendjes civile, që përzgjidhen në bazë të sistemit të pikëzimit, të përcaktuar në tabelën 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Për kategorinë e përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij vendimi, përfituesit përzgjidhen në bazë të sistemit të pikëzimit, të përcaktuar në tabelën 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Në rast se rezultojnë më shumë kandidatë me pikë të barabarta sesa kuotat e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, përzgjedhja e tyre do të realizohet sipas sistemit të pikëzimit, të përcaktuar nga vetë institucioni përfitues.

5. Punonjësit e administratës publike përfitues përfitojnë kredi me interes 0%.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Tabela nr. 1

	KRITERET E PIKËZIMIT	100 pikë
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	50
A	Nuk disponojnë banesë në pronësi	
B	Banojnë në banesa në rrezik shembjeje, kanë ngelur ose rrezikojnë të mbeten të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore	
C	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.	
Ç	Familjet që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor	
D	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike.	
1.2	KUSHTET FAMILJARE/SOCIALE/PUNËSIMI	50
A	Të kenë pagën më të ulët sipas përcaktimit të vendimit të Këshillit të Ministrave	
B	Punonjësit, sipas shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij vendimi të cilët, në momentin e aplikimit, kanë jo më pak se dy vite të punësuar në administratën publikë.	

Tabela nr. 2

	KRITERET E PIKËZIMIT	100 pikë
--	-----------------------------	-----------------

1.1	KUSHTET E STREHIMIT	50
A	Nuk disponojnë banesë në pronësi	
B	Banojnë në banesa në rrezik shembjeje, kanë ngelur ose rrezikojnë të mbeten të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore	
C	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.	
Ç	Familjet që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor	
D	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike.	
1.2	Vetëdeklarim që është i angazhuar në institucionin shëndetësor publik, në një ose më shumë kategoritë e mëposhtme:	50
A	Mjek i punësuar në sistemin shëndetësor publik, që ka nënshkruar marrëveshjen me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Universitetin e Mjekësisë së Tiranës dhe ushtron profesionin pas përfundimit të ciklit të dytë të studimeve për “Mjekësi të Përgjithshme” në sistemin shëndetësor publik me kontratë pune sipas legjislacionit në fuqi.	
B	Mjek i punësuar në sistemin shëndetësor publik, që ka nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për ushtrimin e profesionit pas përfundimit të ciklit të specializimit në shërbimin spitalor me kontratë pune sipas legjislacionit në fuqi.	
C	Mjek me kontratë pune sipas legjislacionit në fuqi në sistemin shëndetësor publik, që punon mbi 80 km larg vendbanimit ose në zona rurale apo qendra sekondare apo terciare.	
Ç	Mjek i punësuar në institucionet shëndetësore publike me kontratë pune me afat të pacaktuar.	